



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)**

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 17.03.2021

**Për: Operatorin Ekonomik “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B, me adresë Lagjja “Mustafa Matohiti”, Rruga “Mustafa Matohiti”, banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe, Tepelenë.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim”**

Numri i references së procedurës: **REF-86838-02-12-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Projektim me objekt “Rikonstruksion qendra e Fratarit”, me fond limit 4,161,764.57 (katërmilion e njëqind e gjashtëdhjetë e njëmijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër pikë pesëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, me afat 30 (tridhjetë) ditë.**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.26, datë 22 shkurt 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. Operatori Ekonomik “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 3,530,022.86 (tremilion e pesëqind e tridhjetëmijë e njëzetë e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH**

- 2. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” shpk, me NIPT L01717030C, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 3,495,585.6 (tremilion e katërqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtë) lekë pa TVSH**

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” shpk, me dokumentacionin e paraqitur, nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:**

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.2.4. të kapacitetit ekonomik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur vërtetimi i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin, lidhur me shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “NOVATECH STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7, të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me përvojën e mëparshme, pasi të dyja kontratat e paraqitura për të vërtetuar përvojën e mëparshme, janë në një vlerë më të vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kontrata e lidhur me Bashkinë Maliq Nr.1418 prot, datë 11.04.2018 “Hartimi Projekt-preventiv”Rivitalizim urban qyteti Maliq”, është në vlerën 292,499 lekë pa TVSH.

Kontrata e lidhur me Bashkinë Tiranë Nr.prot.16066/71, datë 20.08.2018 – Loti IX Studim projektim për objektin: “Rikonstruksioni i rrugëve “Bexhet Nelku” dhe “Ahmet Qorraliu”, është në vlerën 1,209,140 lekë pa TVSH.

Të dyja kontratat sëbashku janë në vlerën 1,501,639 lekë pa TVSH, ndërkohë që 40 % i fondit limit është në vlerën 1,664,705.82 lekë pa TVSH.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “NOVATECH STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.3. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7 të dokumentave standarte të tenderit, pasi për drejtuesin teknik (inxhinier elektrik M.Sh.), nuk janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për muajin e fundit.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “NOVATECH STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.7. të kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 7 të dokumentave standarte të tenderit, pasi oferta e paraqitur është në një vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktor në bazë të parashikimeve të VKM Nr.354 date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga OE “NOVATECH STUDIO” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “HE & SK 11” shpk, me NIPT L19008502B, me adresë Lagjja “Mustafa Matohiti”, Rruga “Mustafa Matohiti”, banesa nr.31, shkalla nr.1, kati përdhe, Tepelenë,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **3,530,022.86** (tremilion e pesëqind e tridhjetëmijë e njëzetë e dy pikë tetëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH,** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.03.2021

Ankesa: Për këtë procedurë nuk ka patur ankesa.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Qerim Ismailaj**